



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.3713/25 prot

Datë 19.05.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 669/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.05.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 294/2026, datë 23.02.2026 për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-72884-12-18-2025, me objekt: “Blerje pajisje mjekësore CT Skanner për Shërbimin e Urgjencave Polivalente”, me fond limit 67,142,800.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.

**Ankimues:** Operatori Ekonomik “Health & Light” SHPK, me NUIS L42231011L dhe adresë: Njësia Bashkiake Nr.2, Rruga “Themistokli Gërmenji” Nd. 11, H. 4, Ap.4, Tiranë.

Operatori Ekonomik “Montal” SHPK, me NUIS J62009007F dhe adresë: Dervish Hima-3 Kullat, K.3 Ap 9/2, Tiranë.

Operatori Ekonomik “Medfau” SHPK, me NUIS J93610823R dhe adresë: Lagja 5, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve të Përqëndruara Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

**Vëren:****I***Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 23.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 294/2026, ku vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Montal” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-72884-12-18-2025, me objekt: “Blerje pajisje mjekësore CT Skanner për Shërbimin e Urgjencave Polivalente”, me fond limit 67,142,800.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Health & Light” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Montal” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
4. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Medfau” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
5. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet dhe sqarimet përkatëse në përputhje me vendimin e KSHA-së dhe arsyetimet e konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
6. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
7. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Health & Light” SHPK.
8. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Montal” SHPK.
9. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Medfau” SHPK.

10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

11. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr.2084/6 prot., datë 14.05.2026, me objekt: “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 636/2026, datë 12.05.2026 për procedurën me objekt: “Blerje pajisje mjekësore CT Skanner për shërbimin e Urgjencave Polivalente” me nr.REF-72884-12-18-2025”, protokolluar me tonën nr. 3714/22 prot., datë 18.05.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, informon se është zbatuar vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.294/2026, datë 23.02.2026.

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr.2084/6 prot., datë 14.05.2026, me objekt: “Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 636/2026, datë 12.05.2026 për procedurën me objekt: “Blerje pajisje mjekësore CT Skanner për shërbimin e Urgjencave Polivalente” me nr.REF-72884-12-18-2025”, protokolluar me tonën nr. 3714/22 prot., datë 18.05.2026, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, informon se është zbatuar vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.294/2026, datë 23.02.2026.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit nr.294/2026, datë 23.02.2026 të KPP-së, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave dhe Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; nenit 46 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-72884-12-18-2025, me objekt: “Blerje pajisje mjekësore CT Skanner për Shërbimin e Urgjencave Polivalente”, me fond limit 67,142,800.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 19.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

